

VENDIM
Nr. 488, datë 25.7.2012

PËR AUTORIZIMIN E “RAMETAL” SHPK PËR IMPORTIN E MBETJEVE METALIKE TË ALUMINIT PËR QËLLIME RICIKLIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar dhe të pikës 2 të nenit 49 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e “RAMETAL” sh.p.k., për importin e mbetjeve metalike të aluminit për qëllime riciklimi, me Kodin Doganor:

- GA 760200 mbetje të aluminit;
- GA 76020011 mbetje të aluminit;
- GA 76020019 mbetje të aluminit;
- GA 96020090 kthime të aluminit;

dhe kodin B1-B1010 të Konventës së Bazelit, sipas anekseve 1 e 2, bashkëlidhur vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”.

2. Sasia e mbetjeve metalike të aluminit që importohet sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 25 000 tonë.

3. Mbetjet importohen nga vendet e Bashkimit Europian, Maqedonia, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia. Transporti bëhet në rrugë tokësore dhe detare, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr. 806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve për importimin, përpunimin dhe riciklimin”. Ambalazhimi i tyre të bëhet në paleta, i presuar ose në thasë plastikë konform aneksit III të vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”. Për çdo transfertë ndërkufitare të mbetjeve, “RAMETAL” sh.p.k. dorëzon të plotësuar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, dokumentin e lëvizjes/transfertës ndërkufitare të mbetjeve, sipas formatit të dhënë në aneksin IV të vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave, dhe monitorimi i tyre të kryhet nga strukturat përkatëse të doganave. Çdo transfertë mbetjesh duhet të jetë e pajisur me raport-analizë, të kryer për aspektin e radioaktivitetit.

4. Kohëzgjatja e lejit të importit të mbetjeve metalike të aluminit nga “RAMETAL” sh.p.k. të jetë për një periudhë kohore 1-vjeçare dhe të fillojë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore, të marrë masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve metalike të aluminit nga “RAMETAL” sh.p.k., pas miratimit të këtij vendimi, për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon, me shkrim, me shtetet eksportuese dhe ato transitore, për autorizimet përkatëse që lejojnë kalimin e kësaj sasive të mbetjeve të aluminit, në përmbushje të kërkesave të Konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha